



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:067252

Datë: 20.01.2025

Numri i dokumentit: 06731901

P.nr.179/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me Gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajqi Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit K.B, nga fshati, Komuna e Istogut, për shkak të veprës penale “*Vjedhja*” nga neni 313 paragrafi 2 i KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.307/2024 të datës 27.02.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 18.12.2024, në prezencën e Prokurores të Shtetit Lumturije Hoxha, nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit K.B, mbrojtësit të pandehurit av.Gani Kelmendi nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare, me datën 20.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 20.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehurit:

K.B, i lindur me datë, në IstoG, me vendbanim rr. “.....”, nr....., në fshatin, Komuna e Istogut, i biri i N. dhe nënës Sh., e vajzërisë, ka të kryer shkollën fillore, i divorcuar, i pa punë, i identifikuar me numër personal të letërnjoftimit, nuk posedon numër telefoni, i nacionalitetit Ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, recidivist, gjendet në vuajtje të dënimit.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më datë 15.01.2024 rreth orës 14:07 minuta, në Pejë, në rr.”.....”, pikërisht në marketin “.....”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, tjetrit i’a merr pasurinë dhe atë të dëmtuarit A.G, në atë mënyrë që pasi i pandehuri hyn në vendin e lartcekur, shkon në fund të marketit, ku merr tri produkte suxhuk, të cilat i vendos brenda pantallonave, e më pas largohet nga marketi, e si pasojë e kësaj të dëmtuarës i shkakton dëmin më vlerë rreth 60 euro,

- Me këtë ka kryer veprën penale “*Vjedhja*” nga neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 40, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, si dhe nenit 313 par.2 të KPRK-së, si dhe neneve 242, 364, 449, 450, 452 të KPPRK-së, të akuzuarve fillimisht i:

G J Y K O N

- I.** Me DËNIM ME BURGIM, në kohëzgjatje prej katër (4) muajsh, e i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Obligohet i pandehuri që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë ne emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej nga tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej nga njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
- III.** I dëmtuari A.G, me vendbanim në rrugën “.....”, nr....., në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me datën 27.02.2024, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.307/2024, kundër të pandehurit K.B nga, Komuna e Istogut, për shkak të veprës penale “*Vjedhja*” nga neni 313 paragrafi 2 i KPRK-së.

Gjykata me datën 18.12.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, në të cilën konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, kanë qenë prezentë Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha nga Prokuroria Themelore në Pejë, i pandehuri K.B, mbrojtësi i të pandehurit av.Gani Kelmendi nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në këtë seancë, pasi që gjykata të pandehurit i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet e tij që i takojnë në procedurën penale sipas KPPRK-së, ashtu që i pandehuri ka deklaruar së i ka kuptuar këto të drejta dhe ashtu që i pandehuri K.B, për mbrojtës pranon av.Gani Kelmendi nga Peja, të caktuar sipas detyrës zyrtare.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, nën shenjën PP/II.nr.307/2024 të datës 27.02.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe tutje ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe pasi që i pandehuri K.B, ka deklaruar që i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë me ç’rast i njëjti me vullnet e vetëdije të plotë ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cilat i vihet në barrë, se ndihet i penduar dhe premton se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tjera penale. Në këtë rast i pandehuri K.B, ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e pranon

fajësinë, për veprën penale e cila i cila i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale “Vjedhja” nga neni 313 paragrafi.2 i KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Prokurorja e shtetit Lumturije Hoxha, ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i plotëson kushtet dhe ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, kryesisht në CD ku shifet i pandehuri duke marr produktin nga marketi andaj gjykatës i propozoj që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e te njëjtit, ndërsa si rrethane lehtësuese ta këtë parasysh pranimin e fajësisë.*

Po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit K.B, av.Gani Kelmendi, ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, i njëjti është bërë në konsultim të mjaftueshëm me mua dhe kërkoj që ti aprovohet.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti i Oficerit, M. B. dt. 16.01.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarën A. G. në Stacion Policor dt. 16.01.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarin, i dt. 04.02.2024, Një (1) CD, po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha, ka deklaruar se: *sa i përket rrethanave lehtësuese të merret pranimi i fajësisë ndërkaq si rrethana rënduese ia lë në vlerësim gjykatës.*

Mbrojtësi i të pandehurit K.B, av.Gani Kelmendi, ka deklaruar se: *meqenëse i mbrojturi im pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë në mënyrë vullnetare kërkoj nga ana e gjykatës që këtë rrethanë ta marrë parasysh, gjendjen ekonomike të tij dhe mënyrën e kryerjes se veprës penale, për të cilën vepër penale është penduar dhe premtimin që ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepër të tillë, andaj kërkoj nga gjykata që të njëjtit ti shqiptoj dënim me kusht ose sa më të butë.*

I pandehuri K.B, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale që kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, i kërkoj falje edhe pronarit të dyqanit, kam qenë në ndikimin e narkotikeve dhe kam qenë në rrugë së bashku me fëmijët dhe bashkëshorten.*

Prandaj, me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Vjedhja*” nga neni 313 paragrafi 2 i KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që vepra penale të kryhet në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjyqtarja e vetme gjykuese në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin K.B, gjeti se i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, faktin që palës së dëmtuar i ka kërkuar falje gjatë seancës fillestare, është penduar për veprën e kryer penale, keqardhjen e shprehur për veprën e kryer, kurse si rrethanë rënduese gjeti se i pandehuri është i dënuar edhe me parë për vepra penale të ngjashme me Aktgjykim të formës së prerë, përkatësisht në Aktgjykimin nën shenjën P.nr.259/2019, i plotfuqishëm me datën 11.12.2019, P.nr.356/2020 i dt. 18.05.2021 i plotfuqishëm me dt.30.06.2021, me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog nën shenjën P.nr.171/21, i datës 20.12.2022, nën shenjën P.nr.384/21 i datës 25.11.2022, i plotfuqishëm me datën 26.01.2023, sipas të cilit është dënuar me dënim me burgim unik efektiv në kohëzgjatje prej 5 muajsh për veprat penale “*Vjedhja*” nga nenin 313 par.1 i KPRK-së dhe “*Lëndim i lehtë trupor*” nga nenin 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, si dhe në Gjykatën Themelore Gjakovë me Aktgjykimin nën shenjën 2023:160135 datës 12.10.2023, i plotfuqishëm me datën 14.11.2023, me Aktgjykimin nën shenjën P.nr.244/2024, i plotfuqishëm me datën 04.06.2024, me aktgjykimin P.nr.123/2024, i plotfuqishëm me datën 06.08.2024, me Aktgjykimin nën shenjën P.nr.271/22, me datën 30.10.2024, me Aktgjykimin PKR.nr.48/2023, i plotfuqishëm 06.11.2024, gjë që të pandehurin e bëjnë recidivist të veprave penale e sidomos atyre kundër pasurisë, kështu që i njëjtin ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i shqiptuar dënim me burgim efektiv në mënyrë që të arrihet qëllimi i dënimit dhe rehabilitimi i të pandehurit.

Gjykata në rastin konkret ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesve me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale e cila është kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të

ardhmen mos të kryejnë veprime të ndaluara - përkatësisht mos të kryejnë vepra penale, si dhe do të ndikojnë tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprat e kryera penale, të bëjnë ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Ndërkaq, sipas nenit 313 par.2 të KPRK-së, përcakton minimumin dhe maksimumin e dënimit konkretisht, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, ku pastaj gjykata duke u mbështetur në rrethanat e rastit konkret bëri individualizimin e dënimit për të pandehurin, andaj gjykata vlerëson se dënimi me burgim do të arrijë qëllimin e dënimit.

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 449 par.1 dhe par. 2 dhe nenit 452 par. 1 të KPPRK-së, e ngarkoi të pandehurin lidhur me për shpenzimet e procedurës, të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar prej fillimit të kësaj procedure e deri në përfundimin e saj, e po ashtu konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të cilat obligohet ti paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit A.G, me vendbanim në rrugën “.....”, nr....., në Pejë, në kontest të rregullt civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë konform dispozitës së nenit 462 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.179/24, me datë 20.01.2025.

Bashkëpunëtore profesionale:

Gjyqtarja e vetme gjykuese:

Leonita Lajqi Mucaj

Blerta KERMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.